

AKT THEMELIMI

I SHOQERISE

"TELEMENIA – ALB" SH.A.



Sot, ne Tirane, me date 22.6.2007, ne prani te noteres Gentiana Brati, notere e dhomes se noterise Tirane, u zhvillua mbledhja themeluese nga aksioneret e shoqerise "TELEMENIA – ALB" SH.A, te cilet vendosen te themelojne nje shoqeri anonime pa oferte publike, ne perputhje me Ligjin Nr.7638 dt.19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", kreu V, seksioni II, dhe Ligjin Nr.7667 dt.28.01.1993 "Per regjistrin tregetar".

Aksioneret themelues:

1. **IZHAK ELYASHIV**, i biri i Abraham dhe i Nahama, i datelindjes 20.03.1949, lindur ne Izrael dhe banues ne 14 HaShalom Street, Hod HaSharon, 45203, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes nr. 10906806.
2. **ARDIAN KIMÇA**, i biri i Ejllit dhe i Kushes, i datelindjes 13.07. 1971, lindur ne Shkoder dhe banues ne Shkoder, Lagjja "3 Heronjt", Rruga "Skenderbeg", Nr. 98, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes nr. Z 0212325.
3. **NDREK KIMÇA**, i biri i i Ejllit dhe i Kushes, i datelindjes 21.02.1966, lindur ne Shkoder dhe banues ne Shkoder, "3 Heronjt", Rruga "Skenderbeg", Nr. 97, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes nr. Z 0005192.
4. **ÇESK KIMÇA**, i biri i i Ejllit dhe i Kushes, i datelindjes 17.07.1968, lindur ne Shkoder dhe banues ne Shkoder, "3 Heronjt", Rruga "Skenderbeg", Nr. 99, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes nr. Z 0005189.

Te quajtur me poshte "Ortake Themelues" ne perputhje me Ligjin Nr.7638 dt.19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe Ligjin Nr.7667 dt.28.01.1993 "Per regjistrin tregtar", vendosen te themelojne shoqerine anonime pa oferte publike si me poshte:

I. Ortaket themelues formojne nje shoqeri anonime pa oferte publike, ne perputhje me Ligjin Nr.7638 dt.19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", kreu V, seksioni II, dhe Ligjin Nr.7667 dt.28.01.1993 "Per regjistrin tregtar".

Emri i shoqerise eshte "TELEMENIA – ALB" SH.A.

Shoqeria me kete emer do te kete vulen e saj. Ne cdo akt te leshuar nga shoqeria eshte e detyrueshme te deklarohen inicialet "sh.a" (qe perfaqesojne tipin e shoqerise) dhe emri i shoqerise "TELEMENIA – ALB".

II. Kapitali themeltar i shoqerise eshte 2.000.000 (njemilion) leke, me vlere nominale nje mije leke per aksion, gjithsej 2000 mije aksione te numertuara nga 1(nje) tek numri i fundit 1.000 (njemije). Regjistri i aksioneve te shoqerise do te mbahet ne drejtorine e saj e cila leshon edhe certifikatat e aksioneve per mbajtesit e tyre. Aksionet e shoqerise jane te gjitha

  (1)  H.E

nominative dhe ne momentin e themelimit te shoqerise ato jane te nenshkruara dhe te shlyera nga mbajtësit e tyre.

KONTRIBUTET NE KAPITAL JANE SI ME POSHTE VIJON:

1. **Izhak Elyashiv**, zoterues i 1200 aksioneve me vlere nominale, me vlere 1.000 leke te nje aksioni, ne shumen prej 1.200.000 (njemilonedyqindmije) leke qe ze 60% (gjashtedhjetë përqind) te kapitalit themeltar te shoqerise.

2. **Ardian Kimça**, zoterues i 280 aksioneve me vlere nominale, me vlere 1.000 leke te nje aksioni, ne shumen prej 280.000 (dyqindetëdhjetëmije) leke qe ze 14% (katermbëdhjetë përqind) te kapitalit themeltar te shoqerise.

3. **Ndrek Kimça**, zoterues i 260 aksioneve me vlere nominale, me vlere 1.000 leke te nje aksioni, ne shumen prej 260.000 (dyqindegjashtedhjetëmije) leke qe ze 13% (trembëdhjetë përqind) te kapitalit themeltar te shoqerise.

4. **Çesk Kimça**, zoterues i 260 aksioneve me vlere nominale, me vlere 1.000 leke te nje aksioni, ne shumen prej 260.000 (dyqindegjashtedhjetëmije) leke qe ze 13% (trembëdhjetë përqind) te kapitalit themeltar te shoqerise.

<i>Emri Mbiemri</i>	<i>Përqindja</i>	<i>Nr. i aksioneve</i>	<i>Vlera ne Leke</i>
1. IZHAK ELYASHIV	60%	1.200	1.200.000
2. ARDIAN KIMÇA	14 %	280	280.000
3. NDREK KIMÇA	13%	260	260.000
4. ÇESK KIMÇA	13 %	260	260.000

III. Objekti i veprimtarise se shoqerise "TELEMENIA – ALB" sh.a. do te jete:

- Ndertim, depozitim, shfrytezim i burimeve ujore dhe natyrore me qellim prodhimin e energjisë elektrike;
- Prodhim, eksport-import, tregtim te materialeve te ndertimit, si dhe te materialeve qe perdoren per industrine e naftes, gazit, ujit dhe minierave.
- Kualifikim, trajnim te specialisteve projektues dhe zbatues te projekteve ne fushat e prodhimit te lendeve dhe materialeve te ndertimit, si dhe per realizimin e punimeve dhe ndertimeve ne sektoret e energjisë, naftes, gazit dhe minierave.
- Krijimin e Agjensive dhe Instituteve per zbatim, kerkim e zhvillim te teknologjive te reja.
- Krijimin e linjave dhe njesive te vogla dhe te medha per prodhim dhe tregtim te energjisë elektrike me burime natyrore dhe alternative.
- Importim – eksportim, tranzitim, ndermjetesim, furnizim me energjisë elektrike.
- Importim-eksportim dhe tregtim te linjave te prodhimit dhe teknologjive per prodhimin dhe shfrytezimin e burimeve energjetike.

IV. Keshilli Mbikeqyres i shoqerise te perbehet nga 3 (tre) persona.

Anetaret e Keshillit mbikeqyres jane:

1- **Avner KURZ** (Kryetar)

Akti i Themelimit te Shoqerise Anonime "TELEMENIA – ALB"

i biri i Maccabi dhe i Rachel lindur me 07.4.1952, ne Izrael, mbajtes i pasaportes Izraelite me numer 10900468.

2- Ndrek Kimça (Anetar)

i biri i Ejllit dhe i Kushes lindur me 21.02.1966, ne Shkoder, mbajtes i pasaportes Shqiptare me numer Z 0005192.

3- Mark Kentsis (Anetar)

i biri i Ariehe dhe i Pessia lindur 22/1/1955, ne Kishinev, USSR, mbajtes i pasaportes Izraelite me numer 9684378.

V. Drejtoria e shoqerise do te perbehet nga 1 (nje anetar).

Drejtori i Pergjithshem do te jete **Ardian Kimça** i biri i Ejllit dhe i Kushes, i datelindjes 13.07. 1971, lindur ne Shkoder dhe banues ne Shkoder, Lagjja "3 Heronjt", Rruga "Skenderbeg", Nr. 98.

VI. Eksperti Kontabel i Shoqerise

Eksperti i pare kontabel i autorizuar i shoqerise "TELEMENIA – ALB" sh.a. eshte **Znj. Eftali Qirjaqi**, me numer license Nr. 11, e bija e Koles dhe e Sofes, lindur ne Sarande me 1.01.1959, dhe mbajtëse e pasaportes nr. 1115944.

VII. Shoqeria "TELEMENIA – ALB" do te zhvilloje aktivitetin per nje periudhe kohore te pacaktuar. Personaliteti juridik fitohet me rregjistrimin e kesaj shoqerie ne rregjistrin tregtar.

VIII. Shoqeria do te kete seline e saj ne Shkoder ne adresen "Zona Industriale", Perballe Fabrikes se Telave, Shkoder – Shqiperi. Me miratimin e asamblese se jashtezakonshme ajo mund te cele dege, filiale, agjensi dhe perfaqesi ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj.

IX. Krijimi, organizimi dhe funksionimi i shoqerise "TELEMENIA – ALB" sh.a, zhvillohet sipas dispozitave te legjislacionit shqiptar, ne baze te statutit te shoqerise dhe te ketij akti themelimi.

X. Pjese perberese e Aktit te Themelimit eshte Statuti i Shoqerise.

Ky Akt-Themelimi redaktohet ne 8 (tete) kopje origjinale dhe nenshkruhet rregullisht, me vullnet te plote dhe personalisht nga themeluesit.

Akti i themelimit u lexua me ze te larte nga une noterja dhe u nenshkrua me vullnetin e lire dhe te plote nga themeluesit dhe une noterja e vertetoj ate sipas ligjit nr. 7829, date 1.6.1994 "Per noterine".

THEMELUESIT

1. **IZHAK ELYASHIV**, i biri i Abraham dhe i Nahama, i datelindjes 20.03.1949, lindur ne Izrael dhe banues ne 14 HaShalom Street, Hod HaSharon, 45203, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes nr. 10906806.


2. **ARDIAN KIMÇA**, i biri i Ejllit dhe i Kushes, i datelindjes 13.07. 1971, lindur ne Shkoder dhe banues ne Shkoder, Lagjja "3 Heronjt", Rruga "Skenderbeg", Nr. 98, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes nr. Z 0212325.

3. **NDREK KIMÇA**, i biri i i Ejllit dhe i Kushes, i datelindjes 21.02.1966, lindur ne Shkoder dhe banues ne Shkoder, "3 Heronjt", Rruga "Skenderbeg", Nr. 97, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes nr. Z 0005192.

4. **ÇESK KIMÇA**, i biri i i Ejllit dhe i Kushes, i datelindjes 17.07.1968, lindur ne Shkoder dhe banues ne Shkoder, "3 Heronjt", Rruga "Skenderbeg", Nr. 99, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes nr. Z 0005189.

IZHAK ELYASHIV

IZHAK ELYASHIV



ARDIAN KIMÇA

ARDIAN KIMÇA

NDREK KIMÇA

NDREK KIMÇA



ÇESK KIMÇA

Çesk Kimça



NOTERE

GENTIANA BRATI



STATUT

I

SHOQERISE ANONIME

“Telemenia - Alb” SH.A.

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
NOTERE GENTIANA BRATI

Nr. 1744 Rep

Nr. Kol



Sot, ne Tirane, me date 21.06.2007, ne prani te noteres Gentiana Brati, notere e dhomes se noterise Tirane, u zhvillua mbledhja themeluese nga aksioneret e shoqerise "ENERG - ALB" SH.A, te cilet vendosen te themelojne nje shoqeri anonime pa oferte publike, ne perputhje me Ligjin Nr.7638 dt.19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", kreu V, seksioni II, dhe Ligjin Nr.7667 dt.28.01.1993 "Per regjistrin tregtar", dhe hartimin e statutit te kesaj Shoqerie si me poshte vijon:

KAPITULLI I

FORMA, EMERTIMI, SELIA DHE OBJEKTI

Neni 1

Forma juridike

Shoqeria themelohet ne formen e shoqerise anonime pa oferte publike dhe do te funksionojë ne perputhje me dispozitat e ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe sipas ketij statuti dhe aktit te themelimit.

Neni 2

Emertimi

Emertimi i plote i shoqerise eshte "TELEMENIA - ALB" Sh.A
Shoqeria ka stemen dhe vulen zyrtare te saj.

Ne te gjitha aktet dhe dokumentet e dala nga shoqeria te destinuara per te tretet tregohet emertimi i plote i shoqerise si dhe adresa e selise te saj.

Kudo ne kete statut ku citohet "shoqeria" do te kuptohet "TELEMENIA - ALB" sh.a.

Neni 3

Selia dhe rrjeti

Selia e shoqerise eshte ne Shkoder ne adresen "Zona Industriale", Perballe Fabrikes se Telave, Shkoder - Shqiperi.

Shoqeria ka rrjetin e saj ne territorin e Republikes se Shqiperise perbere nga dege, filiale, agjensi dhe perfaqesi ne perputhje me objektin e veprimtarise se saj.

***Neni 4
Kohezgjatja***

Shoqeria themelohet per te ushtruar veprimtari ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe me kete statut per nje afat kohor te pacaktuar.

***Neni 5
Objekti***

Objekti i veprimtarise se kesaj shoqerie do te jete:

- Ndertim, depozitim, shfrytezim i burimeve ujore dhe natyrore me qellim prodhimin e energjise elektrike;
- Prodhim, eksport-import, tregtim te materialeve te ndertimit, si dhe te materialeve qe perdoren per industrine e naftes, gazit, ujit dhe minierave.
- Kualifikim, trajnim te specialisteve projektues dhe zbatues te projekteve ne fushat e prodhimit te lendeve dhe materialeve te ndertimit, si dhe per realizimin e punimeve dhe ndertimeve ne sektoret e energjise, naftes, gazit dhe minierave.
- Krijimin e Agjensive dhe Instituteve per zbatim, kerkim e zhvillim te teknologjive te reja.
- Krijimin e linjave dhe njesive te vogla dhe te medha per prodhim dhe tregtim te energjise elektrike me burime natyrore dhe alternative.
- Importim – eksportim, tranzitim, ndermjetesim, furnizim me energji elektrike.
- Importim-eksportim dhe tregtim te linjave te prodhimit dhe teknologjive per prodhimin dhe shfrytezimin e burimeve energjitike.

KAPITULLI II

KAPITALI THEMELTAR DHE AKSIONET

***Neni 6
Kapitali themeltar***

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 2.000.000 (nje milion) leke, me vlere nominale i mije leke per aksion, gjithsej 2.000 mije aksione te numertuara nga 1 (nje) tek numri i fundit 2000 (nje mije). Regjistri i aksioneve te shoqerise do te mbahet ne drejtorine e saj e cila leshon edhe certifikatat e aksioneve per mbajtesit e tyre. Aksionet e shoqerise jane te gjitha nominative dhe ne momentin e themelimit te shoqerise ato jane te nenshkruara dhe te shlyera nga mbajtesit e tyre.

KONTRIBUTET NE KAPITAL JANE SI ME POSHTE VIJON:

1. **Izhak Elyashiv**, zoterues i 1200 aksioneve me vlere nominale, me vlere 1.000 leke te nje aksioni, ne shumen prej 1.200.000 (njemilonedyqindmije) leke qe ze 60% (gjashtedhete perqind) te kapitalit themeltar te shoqerise.

Statuti i Shoqërise Anonime "TELEMENIA – ALB"

2. **Ardian Kimça**, zoterues i 280 aksioneve me vlerë nominale, me vlerë 1.000 leke të një aksioni, në shumën prej 280.000 (dyqindetëdhjetëmijë) leke që ze 14% (katërmbëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërise.
3. **Ndrek Kimça**, zoterues i 260 aksioneve me vlerë nominale, me vlerë 1.000 leke të një aksioni, në shumën prej 260.000 (dyqindëgjashtëdhjetëmijë) leke që ze 13% (trembëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërise.
4. **Çesk Kimça**, zoterues i 260 aksioneve me vlerë nominale, me vlerë 1.000 leke të një aksioni, në shumën prej 260.000 (dyqindëgjashtëdhjetëmijë) leke që ze 13% (trembëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërise.

<i>Emri Mbiemri</i>	<i>Përqindja</i>	<i>Nr. i aksioneve</i>	<i>Vlera në Leke</i>
1. IZHAK ELYASHIV	60%	1.200	1.200.000
2. ARDIAN KIMÇA	14 %	280	280.000
3. NDREK KIMÇA	13%	260	260.000
4. ÇESK KIMÇA	13 %	260	260.000

Neni 7

Zmadhimi i kapitalit themeltar

Kapitali themeltar i shoqërise mund të zmadhohet sipas modaliteteve dhe menyrave të parashikuara në nenet 150 deri 163 të ligjit Nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".

Zmadhimi i kapitalit themeltar mund të kryhet vetëm me vendim të asamblese të jashtëzakonshme të aksionereve, në bazë të raportit të keshillit mbikqyres, i cili përmban treguesit e kërkuar nga ligji.

Aksionerët kanë të drejtën e përparësise për nënshkrimin e aksioneve të shlyeshme në para që emetohen për zmadhimin e kapitalit. Kjo e drejtë është përpjestimore me shumën e aksioneve të zotëruara nga secili aksioner përpara zmadhimit të kapitalit.

Aksionerët mund të heqin dorë vetëm individualisht nga e drejta për nënshkrimin e aksioneve të reja. Ata mundën gjithashtu të kërkojnë nënshkrimin e një numri më të vogël aksionesh nga sa u takon sipas parimit të përpjestueshmërisë, por me kusht që asambleja të ketë vendosur shprehimisht për këtë.

Neni 8

Zvogelimi i kapitalit themeltar

Zvogelimi i kapitalit themeltar të shoqërise kryhet vetëm me vendim të asamblese të përgjithshme të jashtëzakonshme të aksionereve dhe në pajtim me dispozitat e nenëve 164 deri 166 të ligjit Nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".

Zvogelimi i kapitalit themeltar nëpërmjet riblerjes të aksioneve ose të shpërndarjes rezervave të shoqërise.

Shoqëria nuk mund të bëjë shpërndarje kapitali neqoftese sipas legjislacionit në fuqi, pas shpërndarjes së saj do t'i mbetet me pak se kapitali minimum i detyrueshem.

***Neni 9
Shlyerja e aksioneve***

Aksionet per kapitalin ne para te nenshkruara ne zbatim te nje vendimi per zmadhimin e kapitalit do te shlyhen te pakten 50 per qind te vleres se tyre qe ne momentin e nenshkrimet. Pjesa tjeter e aksioneve do te shlyhet sipas percaktimeve te bera nga Drejtoria e Shoqerise brenda 5 viteve nga data e miratimit te zmadhimit te kapitalit.

***Neni 10
Forma e aksioneve***

Aksionet e shoqerise jane te formes nominative.

Pronesia e aksioneve vertetohet nga regjistrimi i tyre ne emer te aksionereve ne regjistrin e mbajtur per kete qellim nga shoqeria, ne kushtet dhe sipas menyrave te parashikuara nga ligji.

Shoqeria i leshon aksionereve vertetim te regjistrimit te aksioneve ne pronesi te tyre.

***Neni 11.
Shitja dhe transferimi i aksioneve***

Sa kohe qe shoqeria do te jete pa oferte publike, pervec rastit te trashegimise transferimi i pronesise mbi aksionet nje personi joaksionar, duhet te behet me pelqimin e shoqerise sipas procedurave te parashikuara nga neni 207 i ligjit per shoqerite tregtare.

Neqoftese per vleresimin e aksioneve ka vend per ekspertize shpenzimet per kete perballohen per gjysme nga shitesi dhe per gjysme nga bleresi.

***Neni 12
Pandashmeria e aksioneve***

Aksionet jane te pandashme perkundrejt shoqerise.

***Neni 13
Te drejtat dhe detyrimet e lidhura me aksionet***

Çdo aksion jep te drejten e pjesemarrjes ne fitimet e shperndashme vjetore te shoqerise dhe ne tepricen e aktivitet te mbetur ne rastin e nje likuidimi, ne nje pjese perpjestimore me kuoten e kapitalit qe perfaqeson aksioni.

Pervec kesaj ai jep te drejten e votes dhe te perfaqesimit ne asamblete e pergjithshme ne kushtet ligjore dhe statutore.

Aksioneret jane pergjegjes per detyrimet e shoqerise ndaj te treteve dhe per humbjet e saj deri ne masen e shumes nominale te aksioneve qe zoterojne. Çdo kerkim i fondeve pertej kesaj shume eshte i ndaluar.

Te drejtat dhe detyrimet e lidhura me aksionin e ndjekin kete aksion ne cilindo pronar qe ai mund te kaloje.

Pronesia e nje aksioni permban automatikisht te drejten e aderimit ne statutin e shoqerise dhe ne vendimet e asamblese se pergjithshme.

KAPITULLI III

DREJTIMI, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI

Seksioni 1 Keshilli i Mbikqyres

Neni 14. Perberja dhe emerimi

Keshilli Mbikqyres i shoqerise te perbehet nga 3 (tre) persona.

Anetaret e Keshillit mbikqyres jane:

1- Avner KURZ (Kryetar)
i biri i Maccabi dhe i Rachel lindur me 07.4.1952, ne Izrael, mbajtes i pasaportes Izraelite me numer 10900468.

2- Ndrek Kimça (Anetar)
i biri i Ejllit dhe i Kushes lindur me 21.02.1966, ne Shkoder, mbajtes i pasaportes Shqiptare me numer Z 0005192.

3- Mark Kentsis: (Anetar)
i biri i Ariehe dhe i Pessia lindur 22/1/1955, ne Kishinev, USSR, mbajtes i pasaportes Izraelite me numer 9684378.

Ne emerimin e anetareve te Keshillit te Mbikqyrjes respektohen papajtueshmerite apo ndalesat ligjore.

Funksionet e anetareve te keshillit te mbikqyres perfundojne normalisht ne mbarim te mbledhjes se pergjithshme te aksionereve qe vendos per llogarite e ushtrimit te mbyllur e mbajtur ne vitin gjate te cilit mbaron mandati i tyre.

Antaret e keshillit mbikqyres jane te rizgjedhshem.

Ata mund te shkarkohen ne çdo kohe nga mbledhja e pergjithshme e zakonshme e aksionereve.

Neni 15 Vendet bosh ne keshillin e mbikqyrjes

Neqoftese nje ose disa vende ne keshillin mbikqyres mbeten bosh midis dy mbledhjeve te pergjithshme te aksionereve, si rrjedhoje e vdekjes apo doreheqjes, keshilli mund te beje nje ose disa emerime te perkoheshme.

Statuti i Shoqerise Anonime "TELEMENIA - ALB"

Emerimi i anetareve nga vete keshilli duhet te ratifikohet nga mbledhja e pergjithshme me e afert e aksionereve. Ne rastin kur mbledhja e pergjithshme e aksionereve nuk ratifikon anetaret e emeruar nga keshilli vendimet e marra me pare nga keshilli mbeten gjithmone te vlefshme.

Neni 16.

Kryetari i keshillit

Kryetari i Keshillit mbikeqyres i ushtron funksionet e tij gjate tere periudhes se mandatit si anetare te keshillit te drejtuesve.

Keshilli Mbikqyres mund te emeroje, gjithashtu, nje sekretar qofte edhe jashte anetareve te tij, duke caktuar edhe kohezgjatjen e funksioneve te ketij.

Kryetari i keshillit dhe sekretari jane te rizgjedhshem.

Neni 17

Mbledhjet e keshillit te mbikqyrjes

Keshilli i Mbikqyres eshte organ kolegjal, pergjegjes dhe mbikeqyres per zhvillimin e veprimtarise se drejtorise. Ai shqyrton dhe merr vendime vetem nepermjet mbledhjeve te tij.

Keshilli i mbikqyrjes mblidhet nje here ne tre muaj dhe sa here qe e kerkon interesi i shoqerise. Ai mblidhet gjithashtu ne fund te cdo tremujori per te degjuar raportin e drejtorit te pergjithshem.

Mbledhjet e keshillit mbikqyres thirren nga kryetari dhe, ne mungese te tij, nga anetaret e tjere te ketij keshilli. Te drejten e thirrjes se mbledhjeve e kane edhe anetaret e Drejtorise te cilet paraqesin edhe rendin e dites.

Kryetari dhe, ne mungese te tij, njeri nga anetaret mund te therrese mbledhjen e keshillit brenda 15 ditesh kur nje e treta e anetareve te keshillit i paraqesin atij nje kerkese te arsyetuar per kete. Neqoftese kerkeses nuk i jepet rruge autoret e saj mund te procedojne vete ne thirrjen e mbledhjes te keshillit mbikqyres duke treguar rendin e dites te mbledhjes.

Mbledhjet e keshillit te mbikqyrese mbahen ne seline e shoqerise, ose ne nje vend tjeter te treguar ne thirrje.

Si rregull thirrja e mbledhjes duhet t'u dergohet anetareve te keshillit tre dite perpara me leter, telegram ose forme tjeter e shkruar komunikimi.

Çdo thirrje duhet te permbaje çeshtjet kryesore te rendit te dites.

Mbledhjet e keshillit mbikqyres drejtohen nga kryetari dhe, ne mungese te tij, nga anetari me moshe me te madhe.

Neni 18

Vendimet e keshillit mbikqyres

Statuti i Shoqërise Anonime "TELEMENIA – ALB"

Keshilli merr vendime të vlefshme kur në mbledhjen e tij janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve në funksion.

Çdo anëtar i keshillit mund t'i japë mandat një anëtar tjetër për ta përfaqësuar në mbledhjen e keshillit. Çdo anëtar mund të japë vetëm një mandat për të njëjten mbledhje. Anëtar i përfaqësuar nuk merret parasysh në llogaritjen e quorumit të anëtarëve të pranishëm, siç përcaktohet në paragrafin e parë.

Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm ose të përfaqësuar. Çdo anëtar i keshillit ka vetëm një votë dhe nuk mund të përfaqësojë më shumë se një anëtar tjetër.

Në rast votash të barabarta ajo e kryetarit të seances është përcaktuese.

Neni 19

Dokumentimi i mbledhjeve dhe i vendimeve

Keshilli i mbikqyres mban një libër të pranishëm, i cili firmoset nga anëtarët pjesëmarrës në mbledhje.

Justifikimi i numrit të anëtarëve në funksion dhe i emerimit të tyre provohet në mënyrë të vlefshme ndaj të tjerëve vetëm nga tregimi në procesverbalin e çdo mbledhje të emrave të anëtarëve të pranishëm, të përfaqësuar ose të munguar.

Shqyrtimet dhe vendimet e keshillit mbikqyres evidentohen me anë të procesverbaleve të mbajtura në një libër të posacëm (protokoll), i numërtuar dhe i vulosur, që mbahet në seline qendrore të shoqërise në të cilin tregohen, veç të tjerash, anëtarët e pranishëm, të përfaqësuar dhe të munguar si dhe çdo person tjetër që ka asistuar në mbledhjen e keshillit, teresisht ose pjesërisht.

Procesverbalet firmosen nga kryetari i seances dhe të paktën nga një anëtar dhe sekretari i keshillit.

Neni 20

Kompetencat e keshillit mbikqyres

Keshilli i mbikqyres ushtron ato kompetenca të cilat janë të parashikuara në ligjin Nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregëtare", seksioni i shoqërive anonime, me përjashtim të kompetencave që ligji dhe ky statut ia kanë rezervuar asamblese së përgjithshme të aksionerëve ose drejtorit të përgjithshëm

Aktet dhe operacionet e renditura më poshtë janë në kompetencë vetëm të keshillit mbikqyres:

1. Miratimi i rregulloreve të brendshme të shoqërise që përcaktojnë:

- a) strukturën e organizimit dhe të administrimit të shoqërise, duke përfshirë edhe njesitë funksionale dhe administrative të saj, pozicionet mbikqyrese dhe marrëdhëniet raportuese.
- b) detyrat e çdo drejtori departamenti dhe të njesive që ai drejton e mbikqyr.

Statuti i Shoqerise Anonime "TELEMENIA – ALB"

- c) funksionet e komiteteve te tjera te brendshme te ngritura nga keshilli mbikqyres.
1. Miratimi i numrit te pergjithshem te personelit te shoqerise, i kritereve te marrjes ne pune te personelit teknik, i tabelave te pagave dhe i kritereve per dhenien e shperblimeve suplementare.
 2. Pergatitja dhe paraqitja per shqyrtim ne mbledhjen e pergjithshme te aksionereve te gjendjeve financiare vjetore dhe te raportit te veprimtarise.
 3. Thirrja e asamblese se pergjithshme sa here qe kjo eshte e nevojshme dhe ne mbyllje te cdo viti financiar per te miratuar gjendjet financiare vjetore.

Neni 21

Informimi i anetareve te keshillit

Çdo anetar i keshillit mbikqyres ka te drejte te kerkoje dhe te marre nga Drejtoria e shoqerise informacion per çeshtje te natyres administrative; teknike dhe financiare qe i mundesojne atij te verifikojë dhe gjykojë per kushtet ne te cilat zhvillohet veprimtaria e shoqerise dhe te jete plotesisht i qarte per vendimet qe duhen marre apo qe do te merren nga ana e keshillit.

Çdo anetar i keshillit mbikqyres duhet te njoftohet personalisht per mbledhjet e keshillit dhe t'i vihen ne dispozicion ne seline e shoqerise apo t'i dergohen bashke me thirrjen dokumentet dhe raportet qe do te shqyrtohen ne mbledhje.

Shoqeria nuk eshte e detyruar ti jape anetareve te keshillit mbikqyres kopje te proces verbaleve te vendimeve te keshillit, por çdo anetar mund te kerkoje qe te njihet me to ne seline e saj.

Neni 22

Pergjegjesite e anetareve te keshillit mbikqyres

Anetaret e keshillit mbikqyres mbajne pergjegjesi civile solidarisht dhe individualisht, sipas rastit, ndaj te treteve dhe ndaj shoqerise per shkeljet e dispozitave ligjore ose te rregullimeve te zbatueshme per veprimtarine e shoqerise, per shkelje te statutit si dhe per gabimet e bera ne administrimin e shoqerise per shkak te vendimeve te tyre.

Pergjegjesia penale e anetareve te keshillit te mbikqyres percaktohet ne pajtim me dispozitat ligjore ne fuqi.

Seksioni 2

Drejtoria e shoqerise dhe drejtuesit teknike

Neni 23

Drejtori i pergjithshem

Drejtori i Pergjithshem eshte **Ardian Kimça** i biri i Ejllit dhe i Kushes, i datelindjes 13.07.1971, lindur ne Shkoder dhe banues ne Shkoder, Lagja "3 Heronjte" Rruga

Statuti i Shoqerise Anonime "TELEMENIA – ALB"

"Skenderbeg" Nr. 98, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes Z 0212325.

Mandati i funksionit te tij eshte 1 vit me te drejte rizgjedhje.

Drejtori i Pergjithshem perfaqeson shoqerine ne marredheniet me te tretet me kompetenca te plota ne kufijte e objektit te saj, me perjashtim te kompetencave qe ligji ia ka caktuar shprehimisht asamblese se pergjithshme te aksionereve dhe te kompetencave te specifikuara te keshillit mbikqyres.

Kompetencat e anetareve te drejtorise percaktohen ne menyre te detajuar me vendim te Keshillit Mbikeqyres.

Neni 24

Kompetencat e Drejtorit te Pergjithshem

Drejtori i Pergjithshem i shoqerise ushtron te gjitha kompetencat qe nuk i ka Asambleja e Pergjithshme e Aksionereve, si dhe Keshilli Mbikqyres, si dhe eshte i vetmi person qe perfaqeson personalitetin juridik te shoqerise.

Neni 25

Detyrimi per te ruajtur sekretin

Anetaret e Keshillit te Mbikqyres, te drejtorise si dhe te gjithe personat e punesuar ne shoqeri dhe agjente te saj, jane te detyruar te ruajne fshehtesine e çdo informacioni qe marrin gjate kryerjes se detyrave ne shoqeri dhe te mos e perdorin ate per perfitime personale apo per te trete, si gjate kohes qe jane ne funksion ashtu edhe pas largimit te tyre.

Nje detyrim te tille personat e mesiperm e kane edhe per periudhe kohe prej 3 vjetesh mbas largimit te tyre nga funksionet apo nga shoqeria

Keshilli i mbikqyres miraton rregulla e procedura me te hollesishme lidhur me ruajtjen e sekretit nga personat e permendur me siper si dhe per komunikimin e informacioneve autoriteteve apo organeve te cileve kjo e drejte u eshte njohur me ligj.

Seksioni 3

Eksperti Kontabel i Autorizuar

Neni 26

Emerimi dhe shperblimi

Asambleja e Pergjithshme e aksionereve cakton nje ekspert kontabel te autorizuar i zgjedhur nga lista e Institutit te Eksperteve Kontabel te Autorizuar.

Ne caktimin e eksperteve kontabel te autorizuar mbahen parasysh perjashtimet dhe papajtueshmerite e percaktuara nga ligji "Per shoqerite tregtare".

Shperblimi i tij caktohet nga asambleja e aksionereve dhe perballohet nga shoqëria, ne perputhje me tarifat orare te miratuara nga IEKA.

Neni 28
Detyrat dhe te drejtat

Detyrat dhe te drejtat e kontrolloreve te pavarur te shoqerise jane ato te parashikuara nga ligji "Per shoqerite tregtare", dhe nga aktet e tjera ne fuqi qe rregullojne kete profesion.

Asambleja e aksionereve mund t'u kerkoje eksperteve kontabel te autorizuar kryerjen e kontrolleve apo verifikimeve te posacme per çeshtje ne interes te shoqerise.

KAPITULLI IV

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E AKSIONEREVE

Neni 29
Natyra e asambleve dhe karakteri detyrues i vendimeve

Asamblete e pergjithshme te aksionereve cilesohen asamble te zakonshme ose te jashtezakonshme sipas natyres se vendimeve qe ato jane thirrur per te marre.

Çdo asamble e pergjithshme e mbledhur rregullisht perfaqeson teresine e aksionereve me te drejte vote.

Vendimet e asamblese se pergjithshme detyrojne te gjithë aksioneret madje edhe ata qe mungojne ne mbledhje apo qe votojne kunder.

Neni 30
Thirrja dhe vendi i asamblese.

Asamblete e pergjithshme thirren nga keshilli mbikqyres. Ato mund te thirren, gjithashtu, nga eksperti kontabel i autorizuar dhe kur eshte rasti, nga likuiduesi.

Asamblete e pergjithshme mblidhen ne seline e shoqerise ose ne cdo vend tjeter te treguar ne thirrje.

Thirrja e asamblese se aksionareve behet me ane te njoftimit qe i dergohet cdo aksioneri ne adresen e tij me leter rekomande.

Njoftimi duhet te bjere ne doren e aksionareve apo te njihet prej tyre 15 dite perpara mbledhjes se asamblese dhe duhet te permbaje ditën, oren dhe vendin e mbledhjes, natyren e asamblese, dhe rendin e dites.

Kur asambleja e mbledhur nuk ka mundur te marre vendim per shkak se nuk eshte siguruar quorumi i kerkuar mbledhja e dyte thirret jo me vone se nje muaj nga data e thirrjes se pare ne te njejtat forma si e para. Njoftimi ose letrat e thirrjes te mbledhjes se dyte rikujtojne datën dhe rendin e dites.

***Neni 31
Rendi i dites***

Rendi i dites te mbledhjes se asamblese percaktohet nga personi qe kerkon thirrjen e mbledhjes se asamblese.

Asambleja e aksionereve nuk mund te marre ne shqyrtim nje ceshtje qe nuk eshte perfshire ne rendin e dite. Megjithate ajo mundet, ne cdo rrethane, te shkarkoje nje ose disa anetare te keshillit mbikqyres, drejtorin e pergjithshem, dhe te beje zevendesimin e tyre.

Rendi i dites te mbledhjes se asamblese nuk mund te ndryshohet me nje njoftim te dyte.

***Neni 32
Hyrja ne asamble***

Çdo aksioner, pavaresisht nga numri i aksioneve qe zoteron, ka te drejte te asistojë ne mbledhjet e asambleve te pergjithshme dhe te marre pjese ne vendimet e saj, personalisht apo nepermjet nje perfaqesuesi. Hyrja ne mbledhjet e asambleve te pergjithshme behet ne baze te nje dokumenti qe provon identitetin e aksionerit si dhe te rregjistrimit te tij ne regjistrin e aksioneve te shoqërise.

***Neni 33
Evidenca e pjesemarrjes, drejtimi i mbledhjes dhe proces verbalet***

Per çdo mbledhje te asamblese mbahet nje liste prezence e cila permban treguesit qe provojne identitetin e aksionerit dhe aksionet e zoteruara prej tij. Liste prezence firmoset ne ane nga aksioneri ose, kur eshte rasti, nga perfaqesuesi i tij dhe vertetohet per saktesine e saj nga komisioni vëzhgues i mbledhjes.

Mbledhjet e asamblese drejtohen nga kryetari i saj, i cili eshte i zgjedhshem ne cdo mbledhje nga vete aksioneret me perqindjen e thjeshte te votave te aksionereve pjesemarres ne mbledhje.

Ne rastet kur thirrja e mbledhjes eshte bere nga eksperti kontabel i autorizuar, mandatmbajtësi i caktuar nga gjykata apo, likuiduesi, mbledhja drejtohet nga ai qe therret mbledhjen.

Per çdo mbledhje te asamblese hartohet nje proces verbal i cili permban:

- daten dhe vendin e mbledhjes
- menyren e thirrjes
- rendin e dites
- drejtuesi i mbledhjes dhe komisioni i vëzhgimit
- numri i aksioneve qe marrin pjese ne votim
- quorumi i arritur
- permendjen e dokumenteve dhe te raporteve qe jane shtruar ne mbledhje
- nje permbledhje te debateve
- tekstet e projektrezolutave te vena ne votim, ato te miratuara dhe ato te hedhura poshte nga aksioneret.
- rezultatet e votimeve

Statuti i Shoqerise Anonime "TELEMENIA – ALB"

Proces verbalet e mbledhjes te asamblese hartohen ne nje regjister te posacem, i numertuar dhe i vulosur, i cili ruhet ne seline e shoqerise.

Neni 34

Quorumi, votimi, numri i votave

Ne asamblete e pergjithshme, te zakonshme dhe te jashtezakonshme, quorumi llogaritet per teresine e aksioneve qe perbejne kapitalin themeltar te shoqerise.

E drejta e votes qe u perket aksioneve eshte perpjestimore me kapitalin qe ato perfaqesojne.

Çdo aksion i kapitalit i jep zoteruesit te pakten te drejten e nje vote.

Votimi kryhet me doren ngritur, me thirrje emerore ose i fshehte sipas vendimit te komisionit te vezhgimit dhe drejtuesit te mbledhjes se asamblese.

Votimi kryhet e vecante per çdo çeshtje apo vendim.

Neni 35

Asamblete e pergjithshme te zakonshme

Asambleja e pergjithshme e zakonshme mblidhet te pakten nje here ne vit, brenda 6 muajve te vitit pasardhes, per te vendosur mbi llogarite e shoqerise per ushtrimin financiar te mbyllur.

Ajo ka midis te tjerash, kompetencat qe vijojne:

- te miratoje strategjine e zhvillimit afatgjate te shoqerise.
- te miratoje plan-biznesin dhe planin financiar vjetor.
- te miratoje, ndryshoje ose te hedhe poshte llogarite vjetore qe i shtruar per miratim;
- te vendose per shperndarjen dhe destinimin e rezultatit ne pajtim me dispozitat ligjore dhe me statutin.
- te emeroje dhe shkarkoje anetaret e keshillit te mbikqyres.
- te emeroje Ekspertet kontabel te autorizuar.
- te emeroje anetaret e komitetit te kontrollit financiar te brendshem.
- te miratoje ose te mos miratoje emerimet e anetareve te keshillit te mbikqyres te kryera nga vete keshilli si emerime te perkohshme.
- te miratoje pagen e anetareve te drejtorise.
- te caktoj shperblimin e vecante dhe shperblime te tjera te parashikuara ne kete statut per keshillin mbikqyrese.
- te vendose per raportin e ejksperit kontabel te autorizuar lidhur me marreveshjet qe i nenshtrohen autorizimit paraprak te keshillit mbikeqyrs.

Asambleja e zakonshme merr çdo vendim qe nuk sjell ndryshime te statutit.

Ajo merr vendime te vlefshme ne mbledhjen e pare vetem kur aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar zoterojne jo me pak se 50 per qind te aksioneve me te drejte vote. Ne rast se mbledhja e pare nuk realizohet per mbledhjen e dyte nuk kerkohet asnje lloj quorumi.

Asambleja e zakonshme merr vendim me shumicen e votave qe zoterojne aksioneret e pranishem apo te perfaqesuar.

Neni 36

Asambleja e pergjithshme e jashtezakonshme

Asambleja e pergjithshme e jashtezakonshme mblidhet sa here qe duhet te merret nje vendim qe sjell ndryshime te ketij statuti.

Ajo nuk mund te shtoje detyrimet e aksionereve pervec operacioneve qe rrjedhin nga rigrupimi i aksioneve i kryer rregullisht.

Asambleja e pergjithshme e jashtezakonshme mund te marre vendime te vlefshme ne mbledhjen e pare vetem kur aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar zoterojne te pakten 3/4 e aksioneve me te drejte vote. Per mbledhjen e dyte ky qorum eshte jo me pak se 1/2 e aksioneve me te drejte vote.

Ne rastin e perfshirjes se aksionereve te rinj te shoqerise me ane te bashkimeve, ndarjes, thithjes apo pjesemarrjes ne kapitalet e shoqerive te tjera, vendimet e asamblese merren me 100% te votave te aksioneve me te drejte vote.

Neni 37

Venia ne dispozicion te aksionereve te dokumenteve dhe informacioneve

Shoqeria mban dhe ve ne dispozicion te aksionereve, ne kushtet dhe ne afatet e parashikuara nga ligji, raportet, dokumentet dhe llogarite vjetore qe shqyrton asambleja.

Me perjashtim te inventareve dhe te ndonje dokumenti tjeter te caktuar nga asambleja, dokumentet qe duhet t'u vihen ne dispozicion aksionereve u dergohen ketyre bashke me njoftim-thirrjen per mbledhje.

KAPITULLI V
KONTABILITETI, GJENDJET FINANCIARE,
CAKTIMI I REZULTATIT

Neni 38

Kontabiliteti, inventari, gjendjet financiare

Shoqeria mban kontabilitetin e saj ne pajtim me kerkesat e ligjit "Per kontabilitetin".

Ajo kryen nje here ne 12 muaj inventarizimin e aktiveve dhe te pasiveve te saj, perpara se te pergatite gjendjet financiare vjetore.

Ne mbyllje te cdo viti financiar, por jo me vone se 3 muaj nga data e mbylljes se vitit, shoqeria pergatit gjendjet financiare vjetore sipas rregullave te caktuara per kete qellim.

Viti financiar per te cilin pergatiten dhe publikohen gjendjet financiare te shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon me 31 dhjetor.

Neni 39
Rezultati financiar

Rezultati financiar i shoqerises percaktohet ne mbyllje te cdo viti si difference midis te ardhurave dhe shpenzimet pasi te zbriten, gjithashtu, amortizimet dhe shumat e provizioneve per zhvleresime dhe per rreziqe e shpenzime, perjashtuar shumat e rezervave teknike te krijuara ne peruthje me reregullat per shoqerite e sigurimeve.

Fitimi neto i shoqerise percaktohet pasi te zbritet tatimi mbi fitimin i llogaritur ne menyre te pergendruar per shoqerine ne teresi.

Neni 40
Caktimi(ndarja) e fitimit neto.

Fitimi neto i shoqerise caktohet per qellimet qe vijojne :

1. Per rezerven e domosdoshme te parashikuar nga neni 2,3 i ligjit "Per shoqerite tregtare"
2. Per rezervat e detyrueshme te tjera te kapitaleve te veta
3. Per dividente.

Asambleja e pergjithshme mund te vendose heqjen e nje pjese te fitimeve per krijimin e rezervave te lira per t'u perdorur ne interes te zhvillimit te shoqerise.

Fitimet e shoqerise nuk mund te caktohen per shperblime apo perfitime te tjera te personelit, per sponsorizime apo dhurime dhe as per ndonje qellim tjeter qe ka natyre shpenzimi dhe hyn ne koston e aktivitetit te shoqerise.

Neni 41
Fitimi i shperndashem-Dividendet

Fitimi i shperndashem si dividend perbehet nga fitimi neto i vitit financiar i pakesuar me humbjet e mbartura dhe me shumat e hequra per rezervat ne zbatim te ligjit dhe te statutit dhe i shtuar nga fitimet e mbartura.

Fitimi i shperndashem ndahet midis te gjithë aksionereve ne perpjestim me numrin e aksioneve qe zoteron secili prej tyre.

Perpara shperndarjes se dividenteve nga fitimi i realizuar prej shoqerise, ky fitim do te shkoje per rikthimin e vlerave financiare te investuara per ndertimin e objektit kryesor te shoqerise.

Shoqeria nuk mund te shperndaje dividente neqoftese kapitalet e veta jane ose do te beheshin, si rrjedhoje e shperndarjes, me te vogla nga shuma e kerkuar nga ligji.

Neni 42
Humbjet dhe mbartja e tyre

Pas miratimit te gjendjeve financiare vjetore nga asambleja e pergjithshme, humbja e rezultuar ne nje vit financiar mbartet ne vitet pasues per t'u mbuluar nga fitimet e ardhshme deri ne shuarjen e humbjes.

Statuti i Shoqërise Anonime "TELEMENIA – ALB"

**Neni 43
Likuidimi**

Likuidimi i shoqërisë do të behet veten për shkakë ligjore duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi të parashikuara nga Ligji 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" dhe të ligjit 7667, datë 28.01.1993 "Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen kryer në të.

AKSIONERET

IZHAK ELYASHIV

IZHAK ELYASHIV

ARDIAN KIMÇA

ARDIAN KIMÇA

NDREK KIMÇA

NDREK KIMÇA

ÇESK KIMÇA

Çesk Kimça

NOTERE

GENTIANA BRATI